

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-PT

Data: 22 korrik 2011

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 22 korrik 2011

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E PROKURORISË PËR PRANIMIN E
TRANSKRIPTEVE TË DËSHMIVE ME SHKRIM NË VEND TË DËSHMIVE
GOJORE SIPAS RREGULLËS 92BIS**

Zyrës së Prokurorit:
Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Transkripteve të Dëshmive me Shkrim në Vend të Dëshmive Gojore Sipas Rregullës 92bis me Shtojcë Konfidenciale A”, dorëzuar më 27 qershor 2011 (“Mocion”).

I. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 27 qershor 2011, Prokuroria dorëzoi Mocionin në fjalë. Prokuroria kërkon pranimin e dëshmive me shkrim të 14 dëshmitarëve bazuar në Rregullat 54, 89(C) dhe 92bis të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”).¹ Prokuroria kërkon pranimin e transkripteve të dëshmive të mëparshme gojore të këtyre dëshmitarëve, e deklaratave të tyre dhe provat shoqëruese materiale të përfshira në Shtojcën konfidenciale A të Mocionit,² pa marrjen në pyetje të këtyre dëshmitarëve nga Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj (“Mbrojtja” ose “Të Akuzuarit”).³

2. Më 11 korrik 2011 Ramush Haradinaj (“Haradinaj”) dorëzoi “Përgjigje në Emër të Ramush Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Dëshmive Sipas Rregullës 92bis” (“Përgjigje e Haradinajt”) kundër Mocionit. Po më 11 korrik 2011, Idriz Balaj (“Balaj”) dorëzoi “Përgjigje e Idriz Balajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Dëshmive Sipas Rregullës 92bis” me Shtojcën Publike A” (“Përgjigje e Balajt”) ku e kundërshtonte Mocionin për disa arsye. Në të njëjtën ditë, Lahi Brahimaj (“Brahimaj”) dorëzoi konfidencialisht “Përgjigje ndaj Mocionit 92bis të Prokurorisë” (“Përgjigje e Brahimajt”) duke përdorur argumentet e parashtruara në Përgjigjen e Balajt.

3. Më 15 korrik 2011, Prokuroria dorëzoi “Kërkesë e Prokurorisë për autorizim të Kundërpërgjigjes dhe Kundërpërgjigje Përmbledhëse ndaj përgjigjeve ndaj Mocionit për Pranimin e Transkripteve të Dëshmive me Shkrim në Vend të Dëshmive Gojore Sipas Rregullës 92bis me Shtojcë Konfidenciale A” (“Kundërpërgjigje”) ku kërkon autorizim për paraqitjen e Kundërpërgjigjes ndaj Përgjigjes së Haradinajt dhe përgjigjes së Balajt dhe parashtrimin e argumenteve në lidhje me tri aspekte.

¹ Mocion, para 1.

² Mocion, para 26.

³ Mocion, para 18, 26.

II. PARASHTRIME

A. Mocioni

4. Prokuroria parashtroi se dëshmitë në fjalë plotësojnë kushtet e pranimi të Rregullës 89(C) sepse kanë lidhje me çështjen, kanë vlerë provuese dhe janë të besueshme.⁴ Më tej argumentohet se dëshmitë e paraqitura plotësojnë kushtet e pranimi sipas Rregullës 92bis, sepse nuk shërbejnë si prova për veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarve që pretendon Aktakuza, ndër të cilat pjesëmarrjen e tyre në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të pretenduar (“NPK”), gjendjen e tyre mendore ose synimin e tyre.⁵ Prokuroria parashtroi se transkriptet, deklaratat dhe provat shoqëruese materiale të propozuara përmbajnë prova inkriminuese.⁶

5. Prokuroria pretendon se Dhoma duhet të përdorë kompetencën e saj në dobi të pranimi të dëshmive të paraqitura.⁷ Më tej argumentohet se fakti që dëshmitë e disa prej dëshmitarëve të Rregullës 92bis nuk konfirmojnë dëshmi të tjera, duhet të merret parasysh në atribuimin e rëndësisë kushtuar dëshmive të propozuara.⁸ Prokuroria parashtroi se asnjë prej faktorëve kundër pranimi, të përmendur në Rregullën 92bis(A)(ii), nuk vlen në lidhje me këto dëshmi.⁹ Argumentohet se nuk ekzistojnë “interesa mbizotëruese publike” në lidhje me dhënien e dëshmive gojore, sepse thuajse të gjithë dëshmitarët e propozuar, përveç dyve, kanë dëshmuar në procesin e parë gjyqësor në lidhje me të njëjtat pika që përbëjnë lëndën e rigjykitit të pjesshëm.¹⁰ Më tej, në lidhje me këtë aspekt argumentohet se qëllimi i Rregullës 92bis(A), për evitimin e shpenzimeve të panevojshme dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, me kusht që të mos shkelen të drejtat e të akuzuarve, vlen edhe më shumë për një rigjykim.¹¹

6. Prokuroria parashtroi se Dhoma nuk duhet t’u kërkojë dëshmitarëve që të paraqiten për t’u pyetur nga Mbrojtja.¹² Argumentohet se disa Dhoma Gjyqësore kanë pranuar se e

⁴ Mocion, para 9, i referohet *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave me Shkrim sipas Rregullës 92bis, 21 mars 2002, para. 6.

⁵ Mocion, para. 6.

⁶ Mocion, para. 6.

⁷ Mocion, para. 14.

⁸ Mocion, para 14, i referohet *Prokurori k. Millutinoviqit*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 92quater, 16 shkurt 2007, para. 11.

⁹ Mocion, para 15.

¹⁰ Mocion, para 16.

¹¹ Mocion, para 17.

¹² Mocion, para 18.

drejta për verifikimin e dëshmitarëve në kontekstin e Rregullës 92bis(A)(ii) nuk është absolute,¹³ dhe duhet marrë në konsideratë së bashku me “procedimin efikas dhe të shpejtë të çështjes gjyqësore.”¹⁴ Më tej pretendohet se faktorët përcaktues për paraqitjen ose mosparaqitjen e një dëshmitari për pyetje nga pala kundërshtare nuk ekzistojnë në këtë çështje,¹⁵ dhe se të gjithë dëshmitarët, përveç dyve, janë marrë në pyetje nga Mbrojtja dhe rrjedhimisht të Akuzuarve u është dhënë mundësia për verifikimin e besueshmërisë së tyre.¹⁶

7. Prokuroria parashtrohet se kur dëshmia pranohet sipas Rregullës 92bis, duhen pranuar edhe provat shoqëruese materiale në rast se ato janë pjesë e pandashme dhe e domosdoshme e dëshmisë.¹⁷ Prokuroria argumenton se ka përfshirë vetëm ato prova materiale të cilat i konsideron të rëndësishme dhe me vlerë provuese për rigjykimin dhe pohon se Mbrojtja është e lirë të propozojë përfshirjen e provave të tjera materiale.¹⁸

B. Përgjigje e Haradinajt

8. Haradinaj kërkon që Dhoma ta rrëzojë Mocionin në lidhje me të gjithë dëshmitarët e propozuar.¹⁹

9. Haradinaj parashtrohet se dëshmitë e Dragosllav Stojanoviqit, Mijat Stojanoviqit, Veselin Stijoviqit, Marijana Angjelkoviqit, Vesel Dizdarit, Stanisha Radosheviqit, Novak Stijoviqit, dhe Dëshmitarit 52 nuk kanë lidhje me akuzat për Jabllanicën të cilat janë lënda e rigjykimit, se Dhoma Gjyqësore në procesin e parë gjyqësor, për asnjë nga këto dëshmi nuk konkludoi se vërtetonte ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal, dhe se “Prokuroria nuk ka provuar se dëshmitë duhen pranuar sepse shërbejnë për vërtetimin e NPK-së siç pretendohet në rigjykim”.²⁰ Në lidhje me dëshmitë e Dragosllav Stojanoviqit, Mijat Stojanoviqit dhe Veselin Stijoviqit, Haradinaj gjithashtu argumenton se dëshmitë e

¹³ Mocion, para 18, i referohet *Prokurori k. Bllagojeviqit*, Lënda Nr. IT-02-60-T, Vendim i Parë mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave me Shkrim dhe Dëshmisë së Mëhershme sipas Rregullës 92bis, 12 qershor 2003, (“Vendimi Bllagojeviq”), para. 14.

¹⁴ Mocion, para 23.

¹⁵ Mocion, para 19, 20, 22.

¹⁶ Mocion, para 22.

¹⁷ Mocion, para 23, i referohet *Prokurori k. Deliqit*, Lënda Nr. IT-04-83-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 92bis, 13 nëntor 2007, para. 15.

¹⁸ Mocion, para 25.

¹⁹ Përgjigje e Haradinajt, para 3, 15.

²⁰ Përgjigje e Haradinajt, para 3.

propozuara shërbejnë si prova për veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarve.²¹ Argumentohet se dëshmitë mjeko-ligjore të Branimir Aleksandriqit, Nebojsa Avramoviqit, Dushan Dunjiqit dhe Harjit Sandhu-së do të jenë të panevojshme duke qenë se Haradinaj do të parashtrojë të njëjtat argumente në lidhje me këto dëshmi siç u ra dakord në procesin e parë, për pikat e rigjykimit;²² dhe se dëshmitë e Dëshmitarëve 78 dhe 79 nuk u pranuan në procesin e parë për shkak se u mungonte vlera provuese, dhe se Prokuroria nuk ka ofruar arsyetim bindës për pranimin e tyre në rigjykim.²³

10. Haradinaj kërkon të lejohet që t'i paraqesë sërish Dhomës parashtrim me shkrim dhe/ose gojor mbi pranueshmërinë e dëshmive duke marrë parasysh nxjerrjen e provave të reja dhe çfarëdo provash të tjera të paraqitura në gjyq, para marrjes së vendimit përfundimtar nga Dhoma.²⁴ Po ashtu Haradinaj argumenton se në rast se ndonjë nga dëshmitë pranohet dhe duke marrë në konsideratë çfarëdo paraqitje materiali apo prove të re, ai rezervon të drejtën për marrjen në pyetje të dëshmitarëve.²⁵

11. Në rast se ndonjë prej dëshmitarëve konsiderohet i pranueshëm, Haradinaj parashtron se ai do ta vërë në dijeni Prokurorinë për përfshirjen me marrëveshje të disa provave shoqëruese materiale, të cilat nuk figurojnë në Shtojcën konfidenciale A të Mocionit.²⁶

C. Përgjigje e Balajt

12. Balaj së bashku me Brahimajn kërkojnë që Dhoma ta rrëzojë tërësisht Mocionin.²⁷ Balaj parashtron se shumica e dëshmive të propozuara nuk kanë lidhje me rigjykimin.²⁸ Argumentohet se meqenëse NPK-ja nuk përfshin tërë UÇK-në, as dëshmitë për veprimet e anëtarëve të UÇK-së jashtë Jabllanicës, as dëshmitë mbi “marrjen në shënjestër dhe keqtrajtimin e individëve të konsideruar kundërshtarë të UÇK-së” (theksi i Balajt) nuk kanë lidhje.²⁹ Më tej ai parashtron se Dhoma e Apelit hamendësoi një “pjesëmarrje më të kufizuar”

²¹ Përgjigje e Haradinajt, para 9.

²² Përgjigje e Haradinajt, para 3.

²³ Përgjigje e Haradinajt, para 3.

²⁴ Përgjigje e Haradinajt, para 4.

²⁵ Përgjigje e Haradinajt, para 4.

²⁶ Përgjigje e Haradinajt, para 14.

²⁷ Përgjigje e Balajt, para 2, 34.

²⁸ Përgjigje e Balajt, para 12.

²⁹ Përgjigje e Balajt, para 15-17.

duke u përqendruar vetëm në Jabllanicë, në rigjykim,³⁰ dhe se Prokuroria duhet “të provojë lidhje midis çfarëdo dëshmie për ngjarje jashtë Jabllanicës dhe zbatimit të NPK-së në Jabllanicë, para pranimit të çdo dëshmie të tillë të jashtme”.³¹ Balaj pretendon se pranimi i dëshmive pa provuar këtë lidhje “do ta paragjykonte haptazi” atë³² dhe vë në dukje konkluzionin e Dhomës së Apelit se “çfarëdo mundësie për paragjykim të tepruar [...] trajtohet paralelisht nëpërmjet përvijimit të kujdesshëm të parametrave të rigjykimit prej Dhomës së Apelit dhe detyrës në vijimësi të Dhomës Gjyqësore për jetësimin e parimeve të një gjykimi të drejtë.”³³ Balaj argumenton se mbi këtë bazë, dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve të propozuar të Rregullës 92bis, me përjashtim të dëshmisë mjeko-ligjore për Pal Krasniqin, nuk kanë lidhje me rigjykimin e pjesshëm.³⁴

13. Më tej, Balaj kërkon që Dhoma ta shtyjë vendimin mbi pranimin e dëshmive të propozuara të katër dëshmitarëve, Branimir Aleksandriq, Dushan Dunjiq, Harjit Sandhu dhe Nebojsa Avramović. Balaj parashtrohet se Prokuroria dhe Mbrojtja kanë negociuar arritjen e një marrëveshjeje për disa dëshmi mjeko-ligjore, ndër të tjera edhe në lidhje me Pal Krasniqin dhe kërkon shtytjen e vendimit të Dhomës deri në përfundimin e negociatave.³⁵

14. Në rast se Dhoma pranon në tërësi ose pjesërisht cilëndo prej dëshmive të propozuara nga Prokuroria, Balaj parashtrohet se ai rezervon të drejtën për rithirrjen e cilitdo prej dëshmitarëve dëshmia e të cilëve është pranuar me shkrim, në qoftë se është e nevojshme, për ruajtjen e së drejtës së tij për gjykim të drejtë bazuar në “dëshmi të tjera të paraqitura, nxjerrje të materialeve të reja apo çfarëdo aspekti tjetër që kushtëzon hulumtim të mëtejshëm”, dhe pyetje për herë të parë ndaj Dëshmitarëve 78 dhe 79.³⁶ Argumentohet se megjithëse e drejta për verifikimin e dëshmive të dëshmitarëve të palës tjetër nuk është absolute, ajo përbën një të drejtë themelore dhe kufizimi i kësaj të drejte për hir të efikasitetit është i papërshtatshëm.³⁷ Gjithashtu, në qoftë se Dhoma pranon në tërësi ose pjesërisht cilëndo prej dëshmive të propozuara, Balaj gjithashtu kërkon pranimin e dëshmive shoqëruese në formë

³⁰ Përgjigje e Balajt, para 24, që i referohet *Prokurori k. Haradinajt*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR73.1, Vendim mbi Apelin e Haradinajt lidhur me Kuadrin e Rigjykimit të Pjesshëm, 31 maj 2011 (“Vendimi i Apelit”).

³¹ Përgjigje e Balajt, para 26.

³² Përgjigje e Balajt, para 26.

³³ Përgjigje e Balajt, para 25, që i referohet vendimit të Apelit, para 26.

³⁴ Përgjigje e Balajt, para 29-33.

³⁵ Përgjigje e Balajt, para 31, 34.

³⁶ Përgjigje e Balajt, para 11, 35.

³⁷ Përgjigje e Balajt, para 7-9, që i referohet Vendimit *Bllagojeviq*, para 14. Konventa Ndërkombëtare mbi Të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 14(2); Konventa Europiane për Të Drejtat e Njeriut, Neni 6(2).

incizimi/filmimi të dëshmitarëve të pranuar, në mënyrë që Dhoma të mund të japë një vlerësim të plotë të sinqeritetit, qëndrimit dhe gatishmërisë ose mosgatishmërisë ndaj pyetjeve të palëve dhe të Dhomës Gjyqësore në procesin e parë,³⁸ si dhe të provave shoqëruese materiale të përfshira në Shtojcën A të Përgjigjes së Balajt.³⁹ Më tej ai parashtrohet se në qoftë se Dhoma pranon dëshminë e një dëshmitari, Prokuroria duhet të redaktojë ato pjesë të dëshmisë që u referohen dëshmime që nuk janë paraqitur.⁴⁰

D. Kundërpërgjigje

15. Prokuroria parashtrohet se në kundërshtim me argumentet e të Akuzuarve, të gjitha dëshmitë e propozuara në përputhje me Rregullën 92bis kanë të bëjnë me rigjykimin e pjesshëm.⁴¹ Konkretisht argumentohet se dëshmitë e Dëshmitarit 52, Vesel Dizdarit, Marijana Angjelkoviqit, Novak Stijoviqit, Stanisha Radosheviqit, Mijat Stojanoviqit, Dragosllav Stojanoviqit dhe Veselin Stijoviqit kanë të bëjnë me rigjykimin dhe kanë vlerë provuese për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal,⁴² dhe parashtrohet se për arsye se NPK-ja është më e gjerë se pikat e rigjykimit të pjesshëm mbi Jabllanicën, nuk është e nevojshme që Prokuroria të vërtetojë “lidhje” midis të gjitha dëshmimeve dhe krimeve në Jabllanicë.⁴³ Më tej Prokuroria parashtrohet në lidhje me këtë aspekt se nuk synon “të mbështetet mbi pretendimin për implikim personal të Haradinajt”, në lidhje me incidentet për të cilat dëshmojnë këta dëshmitarë,⁴⁴ dhe se fakti që Dhoma Gjyqësore në procesin e parë nuk u mbështet në disa prej këtyre dëshmimeve për vërtetimin e qëllimit të përbashkët kriminal në procesin e parë, nuk i nxjerr këto dëshmi pa lidhje me rigjykimin.⁴⁵ Prokuroria parashtrohet se dëshmitë “inkriminuese” të Dëshmitarëve 78 dhe 79 duhen pranuar, megjithëse u përjashtuan nga vendimi i Dhomës Gjyqësore në procesin e parë,⁴⁶ dhe se gjithashtu duhen pranuar dëshmitë mjeko-ligjore (që do të jepen nga Branimir Aleksandriqi, Dushan Dunjiqi, Harjit

³⁸ Përgjigje e Balajt, para 3, 5, 36.

³⁹ Përgjigje e Balajt, para 3, 27, 36, Shtojca A.

⁴⁰ Përgjigje e Balajt, para 28.

⁴¹ Kundërpërgjigje, para 2-10.

⁴² Kundërpërgjigje, para 2.

⁴³ Kundërpërgjigje, para 2-3, që i referohet Vendimit të Apelit, para 31-32, 39; *Prokurori k. Haradinajt*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, 14 janar 2011, para 30.

⁴⁴ Kundërpërgjigje, para 5, që i referohet Përgjigjes së Haradinajt, para 9, 11-12.

⁴⁵ Kundërpërgjigje, para 6.

⁴⁶ Kundërpërgjigje, para 7, që i referohet *Prokurori k. Haradinajt*, Lënda Nr. IT-04-84s-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Shtimin e Dy Dëshmitarëve në Listën e Dëshmitarëve të saj dhe Zëvendësimin e një Dëshmitari me Një Tjetër, 1 nëntor 2007, para 7-8.

Sandhu-ja dhe Nebojsa Avramoviqi), meqenëse palët nuk kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e këtyre dëshmive dhe aktualisht nuk janë në negociata për marrëveshje.⁴⁷

16. Prokuroria parashtroi se asnjëri prej dëshmitarëve të propozuar nuk duhet t'i kërkohej të paraqitet për pyetje nga Mbrojtja, duke theksuar se e drejta për verifikimin e dëshmive të dëshmive të palës kundërshtare nuk është absolute,⁴⁸ dhe duke vënë në dukje veçanërisht rrethanat e këtij rigjykimi ku thuhet se të gjithë dëshmitarët janë pyetur më parë nga të Akuzuarit.⁴⁹ Parashtrohet se, që një dëshmitar i Rregullës 92bis të thirret për pyetje nga Mbrojtja, i Akuzuari duhet të japë arsye konkrete mbi nevojën e pyetjes së dëshmitarit.⁵⁰

17. Në lidhje me provat materiale shoqëruese shtesë, Prokuroria parashtroi se Balaj është i lirë të propozojë përfshirjen e çfarëdo prove materiale që ai e gjykon të përshtatshme.⁵¹ Ajo nuk e kundërshton pranimin e provave materiale të përfshira në Shtojcën A të Përgjigjes së Balajt, me përjashtim të Provës Materiale D22, për të cilën Prokuroria parashtroi se nuk është pranuar në procesin e parë.⁵² Prokuroria nuk kundërshton pranimin e incizimeve/filmimeve në lidhje me dëshmitarë dëshmitë e të cilëve janë pranuar.⁵³

III. LIGJI PËRKATËS

18. Pranueshmëria e dëshmive me shkrim ose gojore trajtohet në Rregullën 89, e cila përcakton se dëshmia e propozuar duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme të pranimin në përputhje me Rregullën 89, me fjalë të tjera duhet të ketë lidhje me çështjen dhe të ketë vlerë provuese e cila nuk zhvlerësohet ndjeshëm prej nevojës për garantimin e një gjykimit të drejtë.⁵⁴

19. Rregulla 92bis e Rregullores trajton procedurën e pranimin në tërësi ose pjesërisht të deklaratave të dëshmitarëve ose transkripteve të dëshmive të dëshmitarëve në vend të dëshmive gojore. Nëpërmjet Rregullës 92bis u synua të përcaktoheshin të ashtuquajtura

⁴⁷ Kundërpërgjigje, para 9-10.

⁴⁸ Kundërpërgjigje, para 11, që i referohet Vendimit *Bllagojeviq*, para 14.

⁴⁹ Kundërpërgjigje, para 11.

⁵⁰ Kundërpërgjigje, para 11.

⁵¹ Kundërpërgjigje, para 12.

⁵² Kundërpërgjigje, para 12.

⁵³ Kundërpërgjigje, para 13.

⁵⁴ *Prokurori k. Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-AR73.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm Lidhur me Rregullën 92bis(C), 7 qershor 2002 ("Vendimi i Apelit *Galiqit*"), para 31; *Prokurori k. Perishiqit*, Lënda Nr. IT-04-81- T; Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave Sipas Rregullës 92bis, 2 tetor 2008, para 10.

dëshmi “inkriminuese”;⁵⁵ kjo rregull mundëson pranimin e deklaratave ose transkripteve në vend të dëshmive gojore me kusht që ato të provojnë një çështje dhe jo veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarit sipas pretendimeve të aktakuzës.

20. “Veprimet dhe sjellja” e të Akuzuarit kuptohet si “shprehje e thjeshtë” së cilës duhet t’i jepet kuptimi i zakonshëm: aktet dhe qëndrimi i të akuzuarit,”⁵⁶ duke përfshirë edhe mosveprimet në rastet përkatëse.⁵⁷ Rregulla 92bis nuk mund të shfrytëzohet për pranimin e deklaratave me shkrim dhe dëshmive që shërbejnë për vërtetimin e veprimeve ose sjelljes së të akuzuarit të cilat i shërbejnë Prokurorisë për të provuar ndër të tjera se vetë i akuzuari kreu cilindo prej krimeve të akuzuara, nxiti ose urdhëroi kryerjen e krimeve të akuzuara, ose ndryshe ndihmoi dhe inkurajoi autorët e pretenduar të krimeve në planifikimin, përgatitjen ose ekzekutimin e krimeve të tyre.⁵⁸ Kur Prokuroria parashton se i Akuzuari mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, Rregulla 92bis përjashton çfarëdo deklarate me shkrim që shërben si provë për çfarëdo veprimi apo sjelljeje të të akuzuarit të cilin Prokuroria e shfrytëzon për të vërtetuar se i akuzuari ka marrë pjesë në atë ndërmarrje të përbashkët kriminale ose kishte synimin e përbashkët të nevojshëm me autorin e krimeve të akuzuara.⁵⁹ “Sjellja” sigurisht që përfshin edhe gjendjen mendore përkatëse të të akuzuarit.⁶⁰ Rrjedhimisht, deklaratat me shkrim që shërbejnë si provë për veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit të cilat i shërbejnë Prokurorisë për të provuar synimin kriminal të të akuzuarit, nuk janë të pranueshme sipas Rregullës 92bis.⁶¹ Deklaratat të cilat shërbejnë si provë për veprimet dhe sjelljen e të tjerëve të cilët kryen krimet për të cilat aktakuza ngarkon të akuzuarin me përgjegjësi individuale (p.sh nëpërmjet formës së ndihmës ose inkurajimit, urdhërimit ose nxitjes së të tjerëve), janë të pranueshme në bazë të Rregullës 92bis.⁶²

⁵⁵ Vendimi i Apelit *Galiq*, para 16, 18.

⁵⁶ *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave me Shkrim sipas Rregullës 92bis, 21 mars 2002, (“Vendimi i Procesit *Millosheviq*”), para. 22.

⁵⁷ Vendimi i Apelit *Galiq*, para 11.

⁵⁸ Vendimi i Apelit *Galiq*, para 10.

⁵⁹ Vendimi i Apelit *Galiq*, para 10.

⁶⁰ Vendimi i Apelit *Galiq*, para 11.

⁶¹ Po aty *Prokurori k. Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave me Shkrim të Dëshmitarëve sipas Rregullës 92bis, 22 janar 2004, (“Vendimi *Strugar*”), para. 7

⁶² Vendimi i Apelit *Galiq*, para 9.

21. Edhe në qoftë se vendoset që një deklaratë me shkrim apo një transkript në vetvete nuk është i papranueshëm, Dhoma ka kompetencë të vendosë për të mos e pranuar.⁶³ Qoftë për faktin se prova mund të jetë kyçe për Prokurorinë, apo personi veprimet dhe sjellja e të cilit përshkruhen në deklaratën me shkrim është i lidhur ngushtë me të akuzuarin, nuk do të ishte e drejtë ndaj të akuzuarit që dëshmia të jepet me shkrim.⁶⁴

22. Paragrafi (C) i Rregullës 92bis përcakton se Dhoma gjithashtu mund t'i kërkojë një dëshmitari, deklarata me shkrim ose transkripti i të cilit është pranuar në bazë të paragrafit (A) të Rregullës 92bis, që gjithsesi të paraqitet në gjyq për pyetje nga pala tjetër. Ky gjykim bëhet duke marrë parasysh detyrimin parësor të Dhomës për mundësimin e një gjykimi të drejtë në përputhje me Nenet 20 dhe 21 të Statutit.⁶⁵ Ekzistojnë disa faktorë të tjerë që duhen marrë parasysh në lidhje me detyrimin e paraqitjes së dëshmitarëve për pyetje nga pala tjetër,⁶⁶ ndër të cilat; (i) a është pyetur dëshmitari nga pala tjetër në procesin e mëparshëm, a mbuluan pyetjet e atij procesi në masë të mjaftueshme të gjitha aspektet që kanë lidhje me mbrojtjen në procesin aktual;⁶⁷ (ii) a u pyet dëshmitari gjerësisht nga një i akuzuar me interes të përbashkët;⁶⁸ dhe (iii) a ka të bëjë dëshmia në fjalë me një “problem të gjallë dhe të rëndësishëm midis palëve dhe jo me një problem anësor ose me shumë pak ndikim.”⁶⁹

IV. DISKUTIM

A. Cështje paraprake

23. Haradinaj dhe Balaj parashtrojnë se dëshmitë e propozuara nga Prokuroria për pranim, për të provuar dhunën e UÇK-së kundër atyre që konsideroheshin kundërshtarë, nuk kanë lidhje me akuzat në Aktakuzën aktuale dhe nuk duhen pranuar.⁷⁰ Konkretisht

⁶³ Prokurori k. Gjorgjeviqit, Lënda Nr. IT-05-87/1-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Transkripteve të Dëshmive të Dëshmitarëve Mjeko-Ligjorë në Vend të Dëshmive Gojore sipas Rregullës 92bis, 11 shkurt 2009, (“Vendimi Gjorgjeviq”), para. 5.

⁶⁴ Vendimi i Apelit Galiq, para 13; Vendimi Gjorgjeviq, para 6.

⁶⁵ Prokurori k. Sikiricës, Lënda Nr. IT-95-8-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Transkripteve sipas Rregullës 92bis, 23 maj 200q, para 4 (“Vendimi Sikirica”); Vendimi Strugar, para 9.

⁶⁶ Prokurori k. Martiqit, Lënda Nr. IT-95-11-T, Vendim mbi Mocionet e Prokurorisë për Pranimin e Dëshmive me Shkrim sipas Rregullës 92bis të Rregullores, 16 janar 2006, (“Vendimi Martiq”), para. 15.

⁶⁷ Vendimi Sikirica, para 4; Vendimi Martiq, para 15.

⁶⁸ Prokurori k. Millosheviqit, Lënda Nr. IT-02-54-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Transkripteve në Vend të Dëshmive Gojore sipas Rregullës 92bis(D) – Transkriptet mbi Foçën, 30 qershor 2003, para 38; Vendimi Martiq, para 15.

⁶⁹ Vendimi i Procesit Millosheviq, para 24-25.

⁷⁰ Përgjigje e Haradinajt, para 3(a); Përgjigje e Balajt, para 12-26.

argumentohet se aksionet e UÇK-së jashtë Jabllanicës nuk kanë lidhje me veprimet që pretendohet se ndodhën në Jabllanicë,⁷¹ as me ndërmarrjen e përbashkët kriminale (“NPK”) që pretendohet në Aktakuzë.⁷² Balaj gjithashtu argumenton se bazuar në NPK-në e pretenduar në Aktakuzë, dëshmitë që shërbejnë si provë për ngjarje jashtë Jabllanicës, duhen shqyrtuar në lidhje me zbatimin e NPK-së në Jabllanicë, që të jenë me vlerë dhe se Prokuroria duhet të provojë lidhjen midis çfarëdo prove për ngjarje jashtë Jabllanicës dhe zbatimit të NPK-së në Jabllanicë, para pranimit të dëshmive të tilla të jashtme.⁷³

24. Dhoma nuk bindet nga argumentet e Haradinajt dhe Balajt. Aktakuza⁷⁴ i ngarkon Haradinajn dhe Balajn me gjashtë pika për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës që pretendohet se u kryen në selinë e shtabit dhe burgun e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) në Jabllanicë. Aktakuza pretendon se dy të Akuzuarit janë individualisht përgjegjës për secilin prej këtyre veprimeve mbi bazën e pjesëmarrjes së tyre të pretenduar në NPK. Brahimaj akuzohet në katër pika mbi bazën e pjesëmarrjes së tij në NPK. Në Aktakuzë pretendohet se qëllimi i përbashkët kriminal i NPK-së ishte “konsolidimi i kontrollit tërësor të UÇK-së mbi Zonën Operative të Dukagjinit nëpërmjet largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë dhe keqtrajtimit të civilëve shqiptarëve kosovarë dhe romë/egjiptianë kosovarë dhe civilëve të tjerë të cilët bashkëpunonin ose mendohej se kishin bashkëpunuar me forcat serbe, ose ndryshe nuk përkrahnin UÇK-në.”⁷⁵ Më tej në Aktakuzë pretendohet se NPK-ja ekzistoi nga marsi 1998 deri në shtator 1998 ose rreth kësaj periudhe, dhe se ndër anëtarët e saj ishin tre të Akuzuarit dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së të cilët kishin synim të përbashkët për kryerjen e krimeve që përfshiheshin në qëllimin e përbashkët kriminal të NPK-së, ndër të cilët një numër individësh të përmendur konkretisht me emër.⁷⁶ Rrjedhimisht, veprimet dhe mosveprimet që kanë të bëjnë me vërtetimin e largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë dhe keqtrajtimit të civilëve shqiptarë kosovarë dhe romë, bashkëpunëtorë të mirëfilltë ose të konsideruar si bashkëpunëtorë ose ndryshe mospërkrahës të UÇK-së, që pretendohet se ndodhën në Zonën Operative të Dukagjinit të UÇK-së në Kosovë, gjatë periudhës mars-shtator 1998, kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me

⁷¹ Përgjigje e Haradinajt, para 3(a).

⁷² Përgjigje e Balajt, para 15, 16.

⁷³ Përgjigje e Balajt, para 21, 26.

⁷⁴ *Prokurori k. Haradinajt e të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt, 21 janar 2011 (“Aktakuza”).

⁷⁵ Aktakuza, para 24.

⁷⁶ Aktakuza, para 25.

vërtetimin e qëllimit të përbashkët kriminal të NPK-së së pretenduar dhe rrjedhimisht kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me vërtetimin e ekzistencës së NPK-së në Aktakuzë dhe me Aktakuzën.

25. Dhoma kundërshton argumentin e Balajt se orvatjet e Prokurorisë për paraqitjen e dëshmive jashtë Jabllanicës shtrembërojnë vendimin e kësaj Dhome dhe Dhomës së Apelit mbi kuadrin e Aktakuzës.⁷⁷ Kohët e fundit Dhoma e Apelit konfirmoi se nëpërmjet urdhërimit për rigjykim të pjesshëm dhe kufizimin e akuzave për të cilat do të rigjykoreshin të Akuzuarit, ajo nuk synonte ndryshimin e kuadrit të NPK-së së pretenduar.⁷⁸ Megjithatë Dhoma mund të nxjerrë përfundim për fajësinë ose pafajësinë e të Akuzuarve vetëm në lidhje me gjashtë pika të Aktakuzës, Dhoma është e autorizuar dhe në fakt duhet të marrë parasysh dëshmi që shtrihen jashtë pretendimeve për krime konkrete që përfshihen në pikat 1 – 6 të Aktakuzës. Gjithashtu Dhoma hedh poshtë argumentin e Haradinajt se meqenëse Dhoma Gjyqësore e procesit të parë konkludoi se asnjë prej dëshmive në fjalë nuk provonte ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal, Prokuroria nuk ka provuar lidhjen e dëshmive të propozuara me rigjykimin.⁷⁹ Të rëndësishëm për përcaktimin nëse dëshmitë e propozuara për pranim kanë lidhje, janë elementët e Aktakuzës në lidhje me të cilët paraqiten dëshmitë dhe jo fakti nëse këto dëshmi në vetvete mund ose mund të mos e provojnë këtë pretendim.

26. Së fundi, Dhoma thekson se Rregulla 92bis mbron të drejtat e të akuzuarve kur dëshmitë paraqiten me shkrim, duke përfshirë edhe mundësinë për pyetje drejtuar dëshmitarëve kur është e nevojshme, për të shmangur paragjykim ndaj të akuzuarit. Në përgjigjet e tyre asnjë prej të akuzuarve nuk parashtroi argument konkret në lidhje me paragjykimin që mund të shkaktohet në rigjykim nga pranimi në formë me shkrim dhe pa pyetje nga Mbrojtja të çfarëdo dëshmie të propozuar nga Prokuroria.

B. Dëshmitë e propozuara për pranim sipas Rregullës 92bis

1. Branimir Aleksandriqi, Dushan Dunjiqi, Nebojsa Avramoviqi dhe Harjit Sandhu

⁷⁷ Shih Përgjigje e Balajt, para 19.

⁷⁸ Vendimi i Apelit, para 32.

⁷⁹ Shih Përgjigje e Haradinajt, para 3(a).

27. Bazuar në Rregullën 92bis Prokuroria kërkon pranimin e transkriptit të Branimir Aleksandriqit në procesin e parë *Haradinaj*⁸⁰ dhe deklaratën e tij me shkrim si dëshmitar. Gjithashtu ajo kërkon pranimin si prova shoqëruese materiale, jetëshkrimin e dëshmitarit, dy materiale letërkëmbimi, aktekspertiza të vendit të ngjarjes me data 15 dhe 16 shtator 1998, dy fotografi ajrore dhe një video që tregon vendndodhjet e kufomave të ndryshme përgjatë kanalit të Radoniqit.

28. Branimir Aleksandriqi, profesor i mjekësisë ligjore në Universitetin e Beogradit dhe Drejtor i Mjekësisë Ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Beograd, dëshmon për pjesëmarrjen e tij si anëtar i ekipit që kreu gjetjen, ekzaminimin pas vdekjes dhe identifikimin e kufomave të paplota të viktimave të gjetura në rrethinën e kanalit të Radoniqit, në komunën e Gjakovës në Kosovë, në shtator 1998. Ndër kufomat u gjet edhe ajo e Pal Krasniqit. Ai përshkruan gjetjen dhe marrjen e kufomave të viktimave si dhe hollësi të vendeve ku u gjetën, pamjen fizike të kufomave, shkallën e shpërbërjes, sendet e afërta të gjetura dhe hollësi të tjera të ngjashme.

29. Prokuroria kërkon të paraqesë si prova transkriptet publike të redaktuara dhe të mbyllura me vulë të dëshmisë së Dushan Dunjiqit në procesin e parë *Haradinaj*, dhe deklaratat e tij si dëshmitar, në versionin publik dhe të redaktuar si dhe të mbyllur me vulë, sipas Rregullës 92bis. Gjithashtu Prokuroria kërkon paraqitjen e provave materiale shoqëruese si më poshtë; jetëshkrimin e dëshmitarit, pamje nga ajri të kanalit, fotografi të kanalit bërë nga policia, fotografi të kufomave nga ekspertë kriminalistë në kanal, procesverbalin e vizitës së parë të vendit të ngjarjes, raporti mbi autopsitë e kryera në kufomat e gjetura më 23 shtator 1998, dhe fotografi të këqyrjes në kanal. Prokuroria kërkon pranimin e aktekspertizës mjeko-ligjore të kufomës R-4 dhe fotografitë bashkëngjitur aktekspertizës dhe aktekspertizën ligjore për kufomën R-9, aktekspertizën mjeko-ligjore origjinale shkruar me dorë dhe fotografi të kufomës.

30. Dëshmitari, profesor në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Beograd, në Universitetin e Beogradit, dëshmon se në shtator 1998 ai kryesoi ekipin hetimor kriminalist që kreu zhvarrimet, autopsitë dhe identifikimin e gjithsej 39 kufomave të gjetura në kanalin e Liqenit të Radoniqit, fermën Ekonomija dhe në rrugën afër Dashinocit. Roli i dëshmitarit

⁸⁰ Prokurori k. *Haradinajt e të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T.

në hetime ishte kryesisht në lidhje me autopsitë dhe identifikimin e kufomave në Hotel Pashtrik, në Gjakovë.

31. Më tej Prokuroria propozon pranimin e transkripteve publike te redaktuara dhe të mbyllura me vulë të dëshmisë së Nebojsa Avramoviqit në procesin e parë *Haradinaj* si dhe deklaratën me shkrim të dëshmitarit, dy plotësues, dhe disa shtojca bashkëngjitur deklaratës në përputhje me Rregullën 92bis. Dëshmitari, punëtor kriminalist serb i SPB-së së Gjakovës, dëshmon mbi pjesëmarrjen e tij në ekipin hetimor të vendit të krimit që punoi në vendet e krimeve në Liqenin e Radoniqit dhe fermën Ekonomija. Gjatë tërë procesit të zhvarrimit dëshmitari ndihmoi ekipin hetimor të vendit të krimit duke bërë fotografi të kufomave dhe të provave. Ai dëshmon se ekipin e SPB-së e çuan në vendin e krimit më 9 shtator 1998, Bekim Kalamashi dhe Zenel Aliaj, dy pjesëtarë të UÇK-së të arrestuar pas një sulmi kundër policisë. Kontrolli fillestar i vendit të ngjarjes zbuloi afërsisht 10 kufoma afër kanalit dhe një kufomë tjetër afër fermës Ekonomija. Gjithashtu ai dëshmon për sulmet kundër civilëve serbë që udhëtonin në rrugën Gjakovë-Pejë natën në janar dhe shkurt 1998, dhe thotë se nga fundi i marsit ose fillimi i prillit 1998, në zonën e afërt nuk kishin mbetur më serbë (shënuar në hartë) të cilët nuk ishin rrëmbyer. Gjithashtu ai dëshmon se ishin rrëmbyer edhe shqiptarë kosovarë të cilët nuk donin të rebeloheshin me armë kundër shtetit, dhe se atij i kujtohej të kishte lexuar një raport mbi zhdukjen e policit Nenad Remishtar. Provat materiale shoqëruese të propozuara për pranim me dëshminë e këtij dëshmitari janë një hartë e zonës së përgjegjësisë së dëshmitarit, një hartë e rrugës Gjakovë-Pejë, një raport mbi veprimtari nga Kodralia e afërme nënshkruar nga Ramush Haradinaj që përmban emrat e anëtarëve të UÇK-së arrestuar nga policia më 3 shtator 1998, një skicë e fermës Ekonomija dhe rrethinës së kanalit, një procesverbal me shkrim i vizitës së vendngjarjes në Liqenin e Radoniqit, dhe fotografi të marra afër kanalit në Liqenin e Radoniqit. Gjithashtu, Prokuroria kërkon pranimin e një harte tjetër të zonës, dy videofilmime të ditës së parë të hetimit të vendit të krimit në Liqenin e Radoniqit dhe një filmim të gërmimit të vendit të krimit.

32. Në përputhje me Rregullën 92bis, Prokuroria kërkon pranimin edhe të transkriptit të dëshmisë së Harjit Sandhu-së në procesin e parë *Haradinaj* dhe deklaratën e tij si dëshmitar. Dëshmitari është hetues i Prokurorisë së Tribunalit dhe në mars 2004, ai bashkëpunoi me Zyrën për Personat e Zhdukur dhe Mjekësinë Ligjore të UNMIK-ut (ZPZHML) dhe Genc Kuqin, djali i Skënder Kuqit, për zhvarrimin e kufomës së Skënder

Kuqit. Më 9 mars 2004, dëshmitari, zyrtarë të ZPZHML-së dhe një ekip policor i UNMIK-ut të prirë nga Genc Kuqi shkuan në një varrezë afër fshatit Dubovik, në komunën e Deçanit ku Genc Kuqi tregoi varrin e të atit dhe zyrtarët e ZPZHML-së e emërtuan varrin “SSA 01” dhe fotografuan varrin dhe rrethinën e tij. Më pas, zyrtarët e ZPZHML-së i dorëzuan dëshmitarit një dosje ku përfshihej urdhri i Gjykatës së Qarkut të Pejës ku autorizohet zhvarrimi, një liste e fotografive të bëra, fotografitë e përmendura në listë dhe aktautopsia. Prokuroria kërkon pranimin si prova shoqëruese materiale, aktautopsinë e Skënder Kuqit dhe listën e fotografive nga çështja e ZPZHML-së SSA-01.

33. Mbrojtja ngre disa kundërshtime në lidhje me pranueshmërinë e dëshmive të propozuara të këtyre katër dëshmitarëve. Haradinaj parashtron se ai do të bëjë të njëjtat parashtrime në lidhje me këto dëshmi si në procesin e parë dhe bazuar në këto parashtrime, ai kundërshton pranimin e këtyre dëshmive.⁸¹ Po ashtu, Balaj parashtron se Mbrojtja dhe Prokuroria kanë qenë në negociata për arritjen e një marrëveshjeje në lidhje me disa prova të kriminalistikës dhe kërkon që vendimi për pranimin e dëshmive të shtyhet deri në përfundimin e negociatave.⁸² Dhoma kujton argumentin e Prokurorisë në Kundërpërgjigje se me gjithë përpjekjet e mëparshme, palët nuk kanë mundur të arrijnë një marrëveshje që do të eliminojë nevojën për Prokurorinë që të paraqesë këto prova dhe aktualisht nuk ka negociata në lidhje me këto prova.⁸³ Duke u bazuar në këtë parashtrim, Dhoma nuk mund të refuzojë pranimin e këtyre provave bazuar në arsyetimin e propozuar nga Mbrojtja.

34. Më tej Haradinaj dhe Balaj parashtrojnë se për aq sa dëshmitë kanë të bëjnë me kufoma të viktimave të papërmendura në pikat e Aktakuzës, këto dëshmi janë të papranueshme.⁸⁴ Në lidhje me provat që kanë të bëjnë me kufomën e Zenun Gashit, Balaj parashtron edhe se konkretisht për këtë pikë ai u shpall i pafajshëm në procesin e parë.⁸⁵ Më herët në vendim, Dhoma e ka analizuar argumentin mbi mungesën e lidhjes së dëshmive që shërbejnë për të provuar aspekte jashtë gjashtë pikave të Aktakuzës. Ajo përsërit se për arsyet e shtjelluara, nuk mund ta pranojë këtë argument.

⁸¹ Përgjigje e Haradinajt, para 3(b).

⁸² Përgjigje e Balajt, para 31.

⁸³ Kundërpërgjigje, para 10.

⁸⁴ Përgjigje e Haradinajt, para 3(b); Përgjigje e Balajt, para 32.

⁸⁵ Përgjigje e Balajt, para 33.

35. Dhoma mendon se transkriptet e dëshmime dhe deklaratat me shkrim të dëshmitarëve Branimir Aleksandriq, Dushan Dunjiq, Nebojsa Avramoviq dhe Harjit Sandhu, të propozuara nga Prokuroria, plotësojnë kushtet për pranim në përputhje me Rregullën 92bis. Dëshmia e Harjit Sandhu-së ka të bëjë me zhvarrimin dhe përshkrimin e kufomës së Skënder Kuqit, një prej viktimave të përmendura në Pikën 5 të Aktakuzës. Dëshmitë e Branimir Aleksandriqit, Dushan Dunjiqit dhe Nebojsa Avramoviqit kanë të bëjnë me zbulimin dhe përshkrimin e kufomës së Pal Krasniqit, një prej viktimave të përmendura në Pikën 5 të Aktakuzës dhe shkakun e vdekjes së tij. Dhoma është e bindur se dëshmitë e propozuara kanë lidhje me akuzën e vrasjes në Pikën 5 të Aktakuzës. Pjesë të dëshmime të këtyre tre dëshmitarëve kanë të bëjnë me zbulimin dhe përshkrimin e kufomave të viktimave që nuk përmenden në Aktakuzë. Dhoma gjykon, se për aq sa këto dëshmi shërbejnë për të provuar keqtrajtimin e civilëve serbë, shqiptarë kosovarë dhe romë, bashkëpunëtorë të mirëfilltë ose të konsideruar si bashkëpunëtorë të forcave serbe, ose ndryshe mospërkrahës të UÇK-së, që ndodhën në territorin e Zonës Operative të Dukagjinit të UÇK-së në Kosovë gjatë periudhës mars-shtator 1998, këto dëshmi mund të kenë lidhje me vërtetimin e ekzistencës së qëllimit të përbashkët kriminal, që pretendohet në paragrafin 24 të Aktakuzës. Këto dëshmi e plotësojnë kushtin e lidhjes me akuzën në përputhje me paragrafin (C) të Rregullës 89 të Rregullores. Duke mbajtur parasysh se këto dëshmi u dhanë me betim nga persona të specializuar në kriminalistikë. Dhoma është bindur se dëshmitë e propozuara kanë vlerë të mjaftueshme provuese dhe janë të pranueshme.

36. Më tej, në lidhje me kushtet e Rregullës 92bis, Dhoma thekson se dëshmitë e Branimir Aleksandriqit, Dushan Dunjiqit, Nebojsa Avramoviqit dhe Harjit Sandhu-së, të propozuara nga Prokuroria, nuk shërbejnë për të provuar veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarve, të pretenduara në Aktakuzë dhe janë të pranueshme në formë të shkruar. Megjithatë këto dëshmi shërbejnë për të provuar akuzat në Pikën 5 dhe rrjedhimisht janë të rëndësishme për Prokurorinë, të Akuzuarit kanë patur mundësinë t'i verifikojnë këto dëshmi në procesin e parë *Haradinaj*. Dhoma është bindur se në rrethanat ekzistuese, është e drejtë të pranohen këto dëshmi pa iu kërkuar katër dëshmitarëve të thirren për pyetje nga Mbrojtja. Gjithsesi Dhoma vë në dukje se transkriptet e dëshmime të Branimir Aleksandriqit dhe Dushan Dunjiqit përmendin fotografi, aktautopsi, videofilmime dhe transkripte nga procese të tjera të Tribunalit, të cilat nuk janë propozuar për pranim në këtë fazë. Pa këto dokumente, transkriptet përkatëse kanë vlerë të kufizuar për Dhomën.

Rrjedhimisht, Prokuroria duhet të redaktojë çfarëdo referencash të tilla nga dy transkriptet e propozuara dhe të informojë Sekretarinë, Dhomën dhe Mbrojtjen para pranimi të transkripteve si prova, ose t'i paraqesë këto dokumente në qoftë se arrin marrëveshje me Mbrojtjen.

2. Vesel Dizdari dhe Dëshmitari 52

37. Prokuroria kërkon pranimin e transkriptit të dëshmisë së Vesel Dizdarit në procesin e parë *Haradinaj* dhe deklaratën me shkrim si dëshmitar në përputhje me Rregullën 92bis. Dëshmitari, shqiptar mysliman nga fshati Kosuriq, dëshmon mbi ekzistencën e selisë së shtabit të UÇK-së në shkollën në Baran, komuna e Pejës, duke treguar se dikur para 7 shtatorit 1998 komandanti i policisë ushtarake, Metë Krasniqi, i kërkoi që të sillte Zenun Gashin në shtabin e UÇK-së në Baran, dhe ai u tregoi dy ushtarëve të UÇK-së shtëpinë e Zenun Gashit ku ata arrestuan Zenun Gashin dhe ia dorëzuan komandant Krasniqit në shtabin e UÇK-së në Baran. Gjithashtu ai dëshmon se komandant Krasniqi urdhëroi dëshmitarin që të kontrollonte shtëpinë e Gashit për armë, ku dëshmitari nuk gjeti gjë.

38. Prokuroria kërkon pranimin edhe të versioneve konfidenciale dhe publike të redaktuara të transkriptit të Dëshmitarit 52 në procesin e parë *Haradinaj* dhe si provë materiale shoqëruese, fletën me pseudonimin e Dëshmitarit 52. Dëshmitari 52 dëshmon mbi zhdukjen më 1 gusht 1998 të Zenun Gashit, polic i dalë në pension jo shumë kohë më parë dhe mbi ngjarjet që i paraprinë këtij incidenti. konkretisht Dëshmitari 52 dëshmon se më 1 gusht 1998, Vesel Dizdari dhe dy burra të tjerë e morën Zenun Gashin me vete, duke thënë se ata kishin urdhër nga komandanti dhe se do ta kthenin për 20 minuta. Mirëpo ai nuk u kthye kurrë. Dy ose tri ditë pas zhdukjes së Gashit, dy persona me emblemën e UÇK-së, shkuan në shtëpinë e tij për të marrë ilaçe. Në fshat, UÇK-ja e kishte shtabin në bodrumin e një shtëpie.

39. Haradinaj kundërshton pranimin e dëshmive të Vesel Dizdarit dhe Dëshmitarit 52 me arsyetimin se dëshmitë e propozuara kanë të bëjnë me ngjarje në një pjesë tjetër të zonës së Dukagjinit, që nuk përbëjnë objekt të rigjyimit, se zhdukja e Zenun Gashit kishte lidhje me kazemat e FARK-ut dhe nuk kishte të bënte aspak me UÇK-në. Ai argumenton se një pjesë e mirë e këtyre dëshmive u paraqitën në procesin e parë, se Dhoma do të duhej të merrte parasysh të gjitha këto dëshmi në qoftë se çfarëdo pjesë e

dëshmime lidhur me këtë zonë veprimesh do të pranohej sipas kërkesës së Prokurorisë.⁸⁶ Balaj e kundërshton pranimin e këtyre dëshmime si dëshmi pa lidhje me rigjykimin.⁸⁷ Për arsyet e përmendura më parë në këtë Vendim, Dhoma nuk është bindur se dëshmitë që shërbejnë për të provuar aspekte të ndryshme nga akuzat në Pikat 1-6 të Aktakuzës, duhen përjashtuar si dëshmi pa lidhje.

40. Dëshmitë e propozuara të Vesel Dizdarit dhe Dëshmitarit 52 kanë të bëjnë me marrjen e paligjshme të një ish-polici nga shtëpia e tij në komunën e Pejës në gusht 1998 dhe rrjedhimisht ka lidhje me ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal siç pretendohet në paragrafin 24 të Aktakuzës. Dëshmitarët i dhanë dëshmitë e propozuara me betim në proces të Tribunalit dhe ato kanë vlerë të mjaftueshme provuese për t'u pranuar. Dëshmitë e propozuara nuk shërbejnë si prova për veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarve që pretendohen në Aktakuzë dhe nuk kanë lidhje me një element kyç të argumenteve të Prokurorisë, për faktin se incidenti i përshkruar në dëshmi nuk përfshihet në ndonjë pikë të Aktakuzës. Dëshmitë e propozuara janë të pranueshme në formë të shkruar. Dëshmitarët ishin të disponueshëm për pyetje nga Mbrojtja në procesin e parë dhe të Akuzuarit kanë patur mundësi t'i marrin në pyetje. Në këto rrethana Dhoma është bindur se dëshmitë e propozuara të Vesel Dizdarit dhe Dëshmitarit 52 mund të pranohen në formë të shkruar duke mos iu kërkuar dëshmitarëve të paraqiten për pyetje.

3. Marijana Angjelkoviqi

41. Prokuroria kërkon pranimin edhe të versioneve konfidenciale dhe publike të redaktuara të transkriptit të dëshmisë së Marijana Angjelkoviqit në procesin e parë *Haradinaj* në përputhje me Rregullën 92bis. Në 1998, dëshmitarja punonte si veprimtare për të drejtat e njeriut, duke i dërguar raporte Qendrës për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd. Ajo u dërgua nga eprorët e saj në Kosovë për hartimin e raporteve mbi pretendimet për sulme kundër serbëve, bazuar në intervistat me fshatarë. Ajo shkoi në Kosovë, ndoshta 18 herë nga shkurti deri në shtator 1998, duke qëndruar çdo herë deri në një javë. Dëshmitarja dëshmoi për bisedat e saj me dhjetëra fshatarë, kryesisht serbë, në komuna ku përfshihej Klina, Deçani, Peja dhe Gjakova. Në këto intervista, civilët serbë përshkruan incidente ndër të cilat të shtëna kundër shtëpive të tyre, ndalime në rrugë, ikje nga fshatrat për shkak të frikës, rrahje, konfiskim armësh, vrasje të anëtarëve të familjes

⁸⁶ Përgjigje e Haradinajt, para 10.

⁸⁷ Përgjigje e Balajt, para 30.

dhe sulme kundër policisë. Gjithashtu ajo dëshmoi se në prill 1998 ajo perceptoi një ndjenjë të përgjithshme pasigurie midis banorëve të zonës që ajo vizitoi dhe shtim të veprimeve gjatë natës dhe fshatarët që intervistoi përshkruan të njëjtën mbresë.

42. Haradinaj dhe Balaj parashtojnë se dëshmia e propozuar nuk ka lidhje me këtë rigjykim duke qenë se nuk ka lidhje me asnjë prej pikave të Aktakuzës, se dëshmitarja nuk e vizitoi Jabllanicën dhe nuk ishte dëshmitare okulare në asnjë prej ngjarjeve të përmendura në Aktakuzë.⁸⁸ Dhoma e ka hedhur poshtë këtë argument më parë në këtë Vendim. Dhoma është e bindur se për aq sa dëshmia bën fjalë për marrje të paligjshme ose keqtrajtim të civilëve serbë, shqiptarë kosovarë ose romë, bashkëpunëtorë të mirëfilltë ose të menduar si bashkëpunëtorë, ose ndryshe mospërkrahës të UÇK-së, që ndodhën në territorin e Zonës Operative të Dukagjinit të UÇK-së në Kosovë gjatë periudhës mars-shtator 1998, dëshmia ka lidhje me qëllimin e përbashkët kriminal dhe me Aktakuzën dhe plotësohen kushtet e paragrafit C të Rregullës 89. Dëshmia e propozuar nuk shërben si provë për veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarve dhe nuk është kyç në argumentin e Prokurorisë. Rrjedhimisht dëshmia me shkrim është e pranueshme në parim, në përputhje me Rregullën 92bis.

43. Prokuroria kërkon pranimin si prove materiale shoqëruese, dokumentin e Rregullës 65ter Nr 00005 që përmban 22 raporte incidentesh të Qendrës të së Drejtës Humanitare bazuar në formularët paraqitur nga dëshmitarja dhe kolegët e saj. Në procesin e parë dëshmitarja u pyet nga Haradinaj dhe Balaj në lidhje me raportet e incidenteve. Brahimaj nuk e shfrytëzoi mundësinë për ta pyetur dëshmitaren. Në këto rrethana Dhoma bindet se dokumenti i Rregullës 65ter Nr 00005 mund të pranohet si provë.

44. Gjithashtu Prokuroria kërkon pranimin si prova materiale shoqëruese, të dy fletoreve të kaltra shënimesh të dëshmitares ku ajo ka transkriptuar deklaratat e dëshmitarëve. Prokuroria kërkon që këto të pranohen si “Fletorja e Kaltër e Shënimeve” 1 dhe 2 dhe si “Ditari i Marijana Angjelkoviqit”, Vëllimet 1 dhe 2. Secili nga dokumentet e propozuara është dokument i madh shumëfaqësh. Megjithëse duket se dokumentet origjinale në BKS janë të njëjta, përkthimet e pakorrigjuara në anglisht ndryshojnë me këto dokumente. Fletorja e Kaltër e Shënimeve 1 përfshin një përkthim më pak të plotë se

⁸⁸ Shih Përgjigje e Haradinajt, para 13; Shih edhe Përgjigje e Balajt, para 30.

Ditari, Vëllimi 1, kurse Fletorja e Kaltër e Shënimeve 2 përmban një përkthim më të plotë se Ditari, Vëllimi 2. Prokuroria nuk bën parashtrime në lidhje me pjesë konkrete të dëshmisë së Marijana Angjelkoviqit së cilës i referohen dokumentet e propozuara.. Nuk janë paraqitur shpjegime në lidhje me ndryshimet midis Fletoreve të Kaltra të Shënimeve 1 dhe 2 dhe “Ditarit të Marijana Angjelkoviqit”, Vëllimi 1 dhe 2. Për asnjë nga katër dokumentet e propozuara nuk është paraqitur përkthim zyrtar. Në këto rrethana Dhoma nuk mund të konkludojë mbi rëndësinë dhe vlerën provuese të katër dokumenteve të propozuara. Dokumentet e emërtuara “Fletorja e Kaltër e Shënimeve” 1 dhe 2 dhe “Ditari i Marijana Angjelkoviqit” Vëllimi 1 dhe 2 nuk do të pranohen si prova në këtë fazë. Prokuroria mund të kërkojë pranimin e faqeve konkrete të këtyre dokumenteve pasi së pari të ketë identifikuar ndryshimet midis dy paketave të dokumenteve. Gjithashtu në një rast të tillë, Prokuroria duhet të identifikojë për cilat faqe të transkriptit të dëshmisë së mëparshme të Marijana Angjelkoviqit e ka fjalën, të cilat kërkon të pranohen. Gjithashtu ajo duhet të ofrojë përkthim zyrtar në anglisht të dokumenteve për të cilat kërkon të pranohen.

4. Mijat Stojanoviqi, Dragosllav Stojanoviqi dhe Veselin Stijoviqi

45. Prokuroria kërkon pranimin e transkriptit të dëshmisë së Mijat Stojanoviqit në procesin e parë *Haradinaj*. Shtëpia e familjes së dëshmitarit ndodhej në afërsi të shtëpisë së Ramush Haradinajt, në kufirin midis fshatrave Gllogjan dhe Dubravë. Dëshmitari dëshmon për praninë e shumë djemve të rinj në fshat në tre muajt e parë të vitit 1998, dhe shumë nga këta djem të rinj mbanin çanta plastike në të cilat ai mësoi ata kishin bomba, dhe për automjete që sillnin material ndërtimi në shtëpinë e Haradinajt, nën të cilat ai zbuloi se ishin fshehur armë. Dëshmitari dëshmon gjithashtu për një luftim në shtëpinë e Haradinajt më 24 mars 1998, gjatë të cilit u përdor një helikopter i policisë dhe pas këtij luftimi ai dhe familja e tij u larguan nga shtëpia e tyre. Ai dëshmon mbi orvatjen e tij për tu kthyer në fshat së bashku me të vëllamë dhe një të afërm tjetër më 18 prill 1998 ku ndaj tij dhe dy burrave të tjerë u shti me armë zjarri, për ata të tre që u çuan në shtëpinë e Smajl Haradinajt në Gllogjan ku ata u keqtrajtuat, për rolin e Nasim Haradinajt dhe Hilmi Haradinajt (babai i Ramushit) në keqtrajtim dhe mbi rrethanat e lirim të dëshmitarit dhe dy të tjerëve. Ai dëshmon se e ka parë Ramush Haradinajn menjëherë pas rrahjeve shumë afër shtëpisë ku ai dhe dy të afërmit e tij u keqtrajtuat.

46. Gjithashtu Prokuroria kërkon pranimin në përputhje me Rregullën 92bis të transkriptit të dëshmisë së Dragosllav Stojanoviqit në procesin e parë *Haradinaj*. Dëshmitari, vëllai i Mijat Stojanoviqit, dëshmon për një incident në tre muajt e parë të vitit 1998 kur ai u ndal në rrugë nga tre shqiptarë kosovarë të cilët e morën në pyetje dhe në lidhje me të shtënat në shtëpinë e Haradinajt më 24 mars 1998. Gjithashtu ai dëshmon për orvatjen e tij për t'u kthyer në shtëpinë e tij më 18 prill bashkë me vëllain e tij Mijatit dhe një të afërm tjetër, kur ndaj tyre u shti me armë zjarri dhe për ngjarjet që vijuan.. Konkretisht, ai dëshmon se ai dhe të afërmit e tij u çuan në shtëpinë e Smajl Haradinajt në Gllogjan ku u rrahën dhe se dëshmitarit i dhanë një lëndë që i shkaktoi alivanosje. Dëshmitari dëshmon se pas rrahjeve, ndërsa dergjej për një farë kohe në korridor në shtëpinë e Smajl Haradinajt, ai pa Ramush Haradinajn dhe se i Akuzuari e shkëlmoi. Gjithashtu ai e përshkruan Ramush Haradinajn si personi që ishte në komandë në shtëpinë e Smajl Haradinajt. Prokuroria kërkon pranimin si prova materiale shoqëruese dokumentet vijuese: një hartë shënuar nga dëshmitari, një fotografi e fshatit Gllogjan, fleta e daljes nga spitali e Dragosllav Stojanoviqit, një fotografi nga ajri e Gllogjanit dhe rrethinës, një fotografi e shtëpisë së Ramush Haradinajt dhe një filmim që sugjerohet se ka lidhje me vëllezërit Stojanoviq dhe të afërmin e tyre.

47. Prokuroria kërkon të paraqesë dëshminë me shkrim të një dëshmitari të tretë në lidhje me të njëjtat ngjarje. Ajo propozon pranimin në përputhje me Rregullën 92bis të transkriptit të dëshmisë së Veselin Stijoviqit në procesin *Haradinaj*. Dëshmitari, i afërm i vëllezërve Stojanoviq, dëshmon se së bashku me Dragosllav dhe Mijat Stojanoviqin ai u orvat të kthehej në shtëpinë e Stojanoviqëve në Dubravë, në prill 1998, kur ndaj tre burrave u shti me armë zjarri, se afërsisht 30 burra me uniforma kamuflimi dhe emblema të UÇK-së hynë në shtëpi dhe i çuan të tre burrat në një shtëpi në Gllogjan ku i morën në pyetje dhe i keqtrajtuat. Gjithashtu ai dëshmon në lidhje me rrethanat e lirimit të dëshmitarit dhe të afërmeve të tij.

48. Haradinaj e kundërshton pranimin e dëshmive të tre dëshmitarëve të lartpërmendur. Ai argumenton se dëshmitë e propozuara shërbejnë si provë për veprimet dhe sjelljen e tij duke qenë se sugjerojnë se ai ishte i pranishëm gjatë rrahjeve të pretenduara. Më tej argumentohet se keqtrajtimi i pretenduar më 18 prill 1998 ndodhi para ekzistencës së konfliktit të armatosur dhe nuk ishte objekt i të drejtës humanitare ndërkombëtare, se këto dëshmi dhe dëshmitë në lidhje me sulmin kundër shtëpisë së

Haradinajt më 24 mars 1998, nuk kanë lidhje me keqtrajtimin e pretenduar në Jabllanicë dhe se sulmi i pretenduar kundër anëtarëve të familjes Stojanoviq nuk ka lidhje me NPK-në për kryerjen e krimeve në Jabllanicë meqenëse pretendohet se rrahjet ishin hakmarrje e çastit si pasojë e implikimit të familjes Stojanoviq në sulmin kundër shtëpisë së Haradinajt më 24 mars 1998.⁸⁹ Balaj e kundërshton pranimin e dëshmimeve të propozuara me arsyetimin se nuk kanë lidhje me rigjykimin.⁹⁰ Në rast se Dhoma pranon tërësisht ose pjesërisht këto dëshmi, Balaj propozon pranimin e dokumenteve vijuese në lidhje me Mijat Stojanoviqin: Deklarata e Dragosllav Stojanoviqit për Prokurorinë, dy raporte incidentesh të Qendrës të Së Drejtës Humanitare, një fotografi nga ajri dhe një artikull gazete në lidhje me Dragosllav Jovanoviqin, dhe dy fotografi të shënuara nga Mijat Stojanoviqi, një raport incidentesh të Qendrës të Së Drejtës Humanitare dhe shënimet e Prokurorisë gjatë verifikimit të dëshmisë së Mijat Stojanoviqit.⁹¹ Prokuroria nuk e kundërshton pranimin e dokumenteve të propozuara nga Balaj, përveç deklaratës me shkrim të Dragosllav Stojanoviqit për Prokurorinë, për të cilën Prokuroria parashtron se nuk u pranua në procesin e parë.⁹²

49. Dhoma mendon se dëshmitë në lidhje me rrahjet e dy vëllezërve Stojanoviq dhe Veselin Stijoviqit më 18 prill 1998, shërbejnë si prova për keqtrajtimin e civilëve serbë, mospërkrahës të UÇK-së, që ndodhi në territorin e Zonës Operative të Dukagjinit të UÇK-së në Kosovë gjatë periudhës mars-shtator 1998. Rrjedhimisht dëshmitë kanë lidhje me qëllimin e përbashkët kriminal që pretendohet në paragrafin 24 të Aktakuzës. Dëshmitë e Mijat dhe Dragosllav Stojanoviqit mbi sulmin e policisë serbe kundër shtëpisë së Haradinajt më 24 mars 1998, kanë lidhje me kontekstin në të cilin ndodhën rrahjet e 18 prillit dhe mund të ndihmojnë në ndriçimin e rrethanave të rrahjeve në kontekstin e qëllimit të përbashkët kriminal të pretenduar. Dhoma është e bindur se dëshmitë kanë lidhje me rigjykimin dhe vlerë të mjaftueshme provuese për t'u pranuar.

50. Mijat Stojanoviqi dhe Dragosllav Jovanoviqi dëshmojnë se e panë Ramush Haradinajn menjëherë pas rrahjeve në shtëpinë ku ndodhën rrahjet (Dragosllav Jovanoviq) ose mjaft afër (Mijat Stojanoviq). Në atë kohë të dëshmitarët kishte gjurmë të dukshme të rrahjeve dhe keqtrajtimit. Dragosllav Jovanoviqi dëshmon se Ramush Haradinaj e sulmoi

⁸⁹ Përgjigje e Haradinajt, para 9.

⁹⁰ Përgjigje e Balajt, para 30.

⁹¹ Përgjigje e Balajt, Shtojca A.

⁹² Kundërpërgjigje, para 12.

kur ai ishte i shtrirë në korridorin e shtëpisë së Smajl Haradinajt. Dhoma kujton se në Aktakuzë pretendohet se Ramush Haradinaj mori pjesë në NPK-në e pretenduar, ndër të tjera nëpërmjet miratimit dhe inkurajimit të sjelljes kriminale të bashkakuzuarve të tij dhe vartësve të tjerë në Zonën Operative të Dukagjinit në vende si objekti i burgimit në Jabllanicë.⁹³ Dhoma gjithashtu thekson se deklaratat me shkrim që shërbejnë si provë për veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve të cilat i shërbejnë Prokurorisë për të vërtetuar synimin kriminal të të akuzuarve, nuk janë të pranueshme sipas Rregullës 92bis. Rrjedhimisht pjesët e identifikuara më sipër të dëshmive të Mitat Stojanoviqit dhe Dragosllav Jovanoviqit nuk janë të pranueshme për këto arsye.

51. Në një pjesë të dëshmisë së propozuar të Mijat Stojanoviqit bëhet fjalë për praninë e madhe të djemve të rinj që mbanin bomba shumë afër shtëpisë së Ramush Haradinajt dhe mbi shkarkimin klandestin të armëve në shtëpinë e Haradinajt. Në Aktakuzë pretendohet se Ramush Haradinaj mor pjesë në NPK-në e pretenduar, ndër të tjera “duke e përdorur shtëpinë e tij si qendër operative dhe duke shfrytëzuar burimet e tjera dhe mbështetjen e familjes Haradinaj në konsolidimin e pushtetit të tij me qëllim ndër të tjera për zbatimin e NPK-së, përfshirë edhe përndjekjen e civilëve.”⁹⁴ Rrjedhimisht kjo pjesë e dëshmisë së Mijat Stojanoviqit nuk është e pranueshme në bazë të Rregullës 92bis, meqenëse shërben si provë për veprimet dhe sjelljen e Haradinajt, të pretenduar në Aktakuzë.

52. Për arsyet e identifikuara në paragrafët 50 dhe 51 të këtij Vendimi, Mijat Stojanoviqit dhe Dragosllav Jovanoviqit do t’u kërkohet të dëshmojnë me gojë e më pas të Akuzuarit do të kenë mundësi t’i pyesin dëshmitarët. Prokuroria do të kërkojë pranimin si prova materiale shoqëruese të propozuara në lidhje me Dragosllav Jovanoviqin kur dëshmitari të paraqitet në gjyq. Balaj do të ketë mundësinë të paraqesë dokumentet që propozon për pranim kur Mijat Stojanoviqi dhe Dragosllav Stojanoviqi të paraqiten në gjyq. Dhoma pranon dëshminë me shkrim të Veselin Stijoviqit në përputhje me Rregullën 92bis.

5. Stanisha Radosheviqi dhe Novak Stijoviqi

⁹³ Aktakuzë, para 28(k).

⁹⁴ Aktakuzë, para 28(d).

53. Prokuroria kërkon të paraqesë në përputhje me Rregullën 92bis versionet e redaktuara publike dhe të mbyllura me vulë të transkriptit të dëshmisë së Stanisha Radosheviqit në procesin e parë *Haradinaj*. Dëshmitari, serb nga Dashinoci në komunën e Deçanit, dëshmon se në prill 1998 ai vizitoi miqtë e tij, Dragosllav Stojanoviqin, Mijat Stojanoviqin dhe Veselin Stijoviqin në spital ku ata i treguan se nga 15 deri më 18 prill 1998, ata ishin mbajtur nga UÇK-ja në shtëpinë e tyre, ndaj tyre ishte shtënë me armë zjarri dhe granatuar, ishin keqtrajtuar dhe rrahur, dhe pastaj ishin liruar. Gjithashtu ai dëshmon se rreth 22 prillit 1998, ai, nëna e tij, Rosanda Radosheviqi, dhe miku i tij, Novak Stijoviqi, u ndaluan nga ushtarë të UÇK-së afër Pozhares, në komunën e Deçanit dhe u detyruan të shkonin me makinë në Gllogjan. Atje, dëshmitari dhe Novak Stijoviqi u morën në pyetje, u rrahën dhe u fyen. Nëna e dëshmitarit dhe Novak Stijoviqi u mbajtën në Gllogjan, kurse dëshmitari u lirua me kushtin që të kthehej dhe të sillte armët e gjuetisë të babait të tij dhe babait të Stijoviqit. Dëshmitari mori armën e gjuetisë së babait të tij pasi u takua me të atin (Sllobodan Radosheviqi) në shtëpinë e tij, ia dorëzoi armën një ushtari të UÇK-së në Pozhare dhe shkoi me makinë në Deçan, mesa duket për të marrë armën tjetër. Mirëpo sapo shkoi atje, ai u paraqit në polici dhe u mjekua në spital. Më tej dëshmitari dëshmon se pasi dëgjoi thashetheme mbi rrëmbimin dhe/ose vdekjen e babait të tij në duar të UÇK-së, rreth datës 9 shtator 1998 një polic e informoi se i ati ishte gjetur i vdekur afër Dashinocit, dëshmitari e identifikoi kufomën e tij në Hotel Pashtrik, në Gjakovë.

54. Gjithashtu Prokuroria kërkon të paraqesë versionet e redaktuara publike dhe të mbyllura me vulë të transkriptit të dëshmisë së Novak Stijoviqit në procesin e parë *Haradinaj*, në përputhje me Rregullën 92bis. Dëshmitari, serb nga Pozharja në komunën e Deçanit, dëshmon se më 21 prill 1998, ai, Stanisha Radosheviqi dhe Rosanda Radosheviqi u arrestuan nga ushtarët e UÇK-së afër Pozhares dhe u çuan në Gllogjan. Ai dëshmon se atje ai dhe Stanisha Radosheviqi u rrahën, u morën në pyetje dhe iu tha se nuk mund të ktheheshin në shtëpi. Ai dëshmon se ai dhe Rosanda Radosheviqi u mbajtën në një shtëpi në Gllogjan për një kohë të shkurtër dhe pastaj u liruan, kurse Stanisha Radosheviqi u lirua pa u mbajtur, për të marrë dy pushkë. Gjithashtu ai dëshmon se Mijat dhe Dragosllav Stojanoviqi dhe Veselin Stijoviqi u çuan nga anëtarë të UÇK-së nga shtëpia e tyre në fshatin Dubravë në shtabin e UÇK-së në Gllogjan, ku u rrahën dhe u keqtrajtuan dhe se dëshmitari mësoi për këtë incident nga nëna e vëllezërve Stojanoviq.

55. Haradinaj kundërshton pranimin e dëshmime të Stanisha Radosheviqit dhe Novak Stijoviqit për të njëjtat arsye që ai parashtroi në mbështetje të kundërshtimit të tij mbi pranimin e dëshmime të Mijat Stojanoviqit, Dragosllav Stojanoviqit dhe Veselin Stijoviqit. Më tej ai parashtron se gjithsesi dëshmitë sugjerojnë se sulmet ishin veprime të çorganizuara, indisplinime dhe keqtrajtime të paautorizuara të kryera nga persona të paidentifikuar, jo nën ndonjë varësi komanduese të përcaktuar dhe se nuk ka prova që keqtrajtimi ishte pjesë e një politike për të sulmuar civilët serbë.⁹⁵ Balaj e kundërshton pranimin e dëshmime të këtyre dy dëshmitarëve me arsyetimin se nuk kanë lidhje me rigjykimin.⁹⁶ Në rast se Dhoma pranon tërësisht ose pjesërisht dëshminë e Novak Stijoviqit, Balaj propozon pranimin e provave materiale shoqëruese si vijon: një listë e anëtarëve të PJP-së, dy dokumente të titulluara përkatësisht “Deklarata për KLD MNJ-në nga Halil Sadikaj” dhe “Deklaratë për KLD MNJ-në nga Kumrije Sadikaj”, një fotografi dhe një Raport i GNK-së.⁹⁷ Prokuroria nuk ka kundërshtime ndaj pranimin të dokumenteve propozuar nga Balaj.

56. Dëshmitë e propozuara të Stanisha Radosheviqit dhe Novak Stijoviqit shërbejnë si provë për keqtrajtimin e civilëve serbë në Zonën Operative të Dukagjinit në prill 1998 dhe rrjedhimisht kanë lidhje me qëllimin e përbashkët kriminal të pretenduar në Aktakuzë. Dhoma është bindur se dëshmitë e propozuara kanë lidhje me akuzat dhe vlerë provuese. Dëshmitë e propozuara nuk shërbejnë si provë për veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarve ose nuk përbëjnë një element kyç të argumentit të Prokurorisë dhe janë të pranueshme me shkrim. Haradinaj e ka pyetur dëshmitarin në procesin e parë, Balaj dhe Brahimaj hoqën dorë nga e drejta e marrjes në pyetje të dëshmitarit. Në këto rrethana Dhoma është e bindur se nuk është e nevojshme që dy dëshmitarët të paraqiten në gjyq për pyetje nga Mbrotjtja. Gjithashtu Dhoma është e bindur se provat materiale shoqëruese në lidhje me dëshminë e Novak Stijoviqit të propozuara për pranim nga Balaj, janë të pranueshme. Dhoma thekson se transkripti i dëshmisë së Stanisha Radosheviqit bën fjalë për pamjen e një embleme të UÇK-së, për harta që iu treguan dëshmitarit dhe u shënuan prej tij dhe për një fotografi. Këto dokumente janë të nevojshme për të kuptuar më mirë transkriptin. Rrjedhimisht, Prokuroria duhet të redaktojë çfarëdo referencash të tilla nga transkripti i

⁹⁵ Përgjigje e Haradinajt, para 11-12.

⁹⁶ Përgjigje e Balajt, para 30.

⁹⁷ Përgjigje e Balajt, Shtojca A.

propozuar dhe të informojë Mbrojtjen, Dhomën dhe Sekretarinë në lidhje me këtë, ose të paraqesë dokumentet që mungojnë në rast se arrin marrëveshje me Mbrojtjen.

6. Dëshmitari 78 dhe Dëshmitarja 79

57. Bazuar në Rregullën 92bis, Prokuroria kërkon të paraqesë deklaratën e Dëshmitares 79. Dëshmitarja dëshmon për zhdukjen e Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt më 20 maj 1998 më fshatin Dollovë ose rreth tij, në komunën e Klinës. Dëshmitarja nuk ishte e pranishme kur dy burrat u rrëmbyen dhe përshkrimi prej saj i keqbërësve të pretenduar bazohet në fjalë të dëgjura. Gjithashtu ajo dëshmon në lidhje me motivet e mundshme të rrëmbimit.

58. Bazuar në Rregullën 92bis, Prokuroria propozon për pranim, deklaratën e Dëshmitarit 78. Dëshmitari dëshmon në lidhje me zhdukjen e Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt. Dëshmitari nuk ishte i pranishëm në rrëmbimin e dy viktimave dhe përshkrimi prej tij i keqbërësve të pretenduar bazohet në fjalë të dëgjura. Gjithashtu ai jep dëshmi të dorës së dytë lidhur me konstatimin e pranisë së Ukë Rexhepajt pas vdekjes së tij të pretenduar.

59. Haradinaj e kundërshton pranimin e dëshmimeve të Dëshmitarit 78 dhe Dëshmitares 79 me arsyetimin se këto dëshmi nuk u pranuan në procesin e parë, pjesërisht për shkak se nuk kishin vlerë provuese të mjaftueshme dhe parashtron se Prokuroria nuk ka ofruar ndonjë arsye për pranimin e tyre në rigjykim.⁹⁸ Balaj ka parashtruar argumente të ngjashme.⁹⁹ Prokuroria kundërpërgjigjet se vendimi i Dhomës Gjyqësore në procesin e parë *Haradinaj* për mospranimin e këtyre dy dëshmitarëve ‘u bazua gjithashtu në arsye praktike, si ‘administrimi i rregullt dhe në kohë i procesit gjyqësor’ dhe ‘afrimi i mbylljes së paraqitjes së çështjes nga Prokuroria.’”¹⁰⁰

60. Dëshmitë e propozuara të Dëshmitarit 78 dhe Dëshmitares 79 shërbejnë si provë për zhdukjen e dy viktimave të përmendura në Pikën 2 të Aktakuzës. Megjithëse këto dy dëshmi në vetvete mund të mos jenë të mjaftueshme për vërtetimin e pretendimeve, ato

⁹⁸ Përgjigje e Haradinajt, para 3(c)

⁹⁹ Përgjigje e Balajt, para 29.

¹⁰⁰ Kundërpërgjigje, para 7.

kanë lidhje me Aktakuzën dhe ofrojnë një farë vlere provuese. Ato janë të pranueshme. Dëshmitë e propozuara nuk shërbejnë si provë për veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarve dhe nuk janë kyçe për argumentin e Prokurorisë. Ato mund të pranohen me shkrim në përputhje me Rregullën 92bis. Mirëpo këto dëshmi kanë lidhje me Pikën 2 të Aktakuzës. Të dy dëshmitarët përshkruajnë individët të cilët pretendohet se rrëmbyen dy burrat, element i rëndësishëm për Prokurorinë. Dëshmitarët nuk dëshmuan në procesin e parë dhe Mbrojtja nuk ka pasur mundësi të verifikojë dëshmitarët. Për të qenë të drejtë me të Akuzuarit, Dëshmitari 78 dhe Dëshmitarja 79 duhet të paraqiten në gjyq për t'iu përgjigjur pyetjeve të Mbrojtjes.

V. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura dhe bazuar në Rregullat 89, 92bis dhe 126bis të Rregullores, Dhoma Gjyqësore:

- (1) **AUTORIZON** Prokurorinë që të paraqesë kundërpërgjigje dhe merr shënim përmbajtjen e Kundërpërgjigjes;
- (2) **MIRATON** Mocionin **PJESËRISHT** dhe **URDHËRON**:
 - a. Në përputhje me Rregullën 92bis të pranohen si prova transkriptet e propozuara të dëshmive dhe/ose deklaratat me shkrim të Branimir Aleksandriqit, Dushan Dunjiqit, Nebojsa Avramoviqit, Harjit Sandhu-së, Vesel Dizdarit, Dëshmitarit 52, Marijana Angjelkoviqit, Veselin Stijoviqit, Stanisha Radosheviqit, Novak Stijoviqit, Dëshmitarit 78 dhe Dëshmitares 79;
 - b. Pranimi i transkripteve të Branimir Aleksandriqit, Dushan Dunjiqit dhe Stanisha Radosheviqit të bëhet varësisht prej plotësimit nga Prokuroria të kushteve të parashtruara përkatësisht në paragrafët 36 dhe 56 të këtij Vendimi;

- c. Pranimi si prova i deklaratave të Dëshmitarit 78 dhe Dëshmitares 79 të kushtëzohet prej paraqitjes së këtyre dëshmitarëve në gjyq për pyetje nga Mbrojtja;
- d. Mijat Stojanoviqi dhe Dragosllav Stojanoviqi të dëshmojnë me gojë;
- e. Dokumentet në përputhje me Rregullën 65ter të numëtuara 01109, 01113, 01114, 01115, 01116, 01135, 01260, 00005, 00380, 00381, 00382, 00384, 00385, 00389, 00405, 00412, 00414, 00416, 00418, 00452, 00453, 00454, 00455, 00366, 01254, 00620, 00623, 00624, 00625, 00630, 00643, 00645, 00646, 00648, 00649, 00654, 00667, 00668, 00669, 00670, 01218, 01219, 01220 dhe 01137 dhe dokumentet ID02-0840, ID00-1685, ID52-0001, ID00-1700, ID52-0002 do të pranohen si prova;
- f. Incizimet zanore dhe filmimet e dëshmive të dëshmitarëve të përmendur në pikën 2(a) të vendimit duhet të pranon si prova materiale të veçanta;
- g. Versionet e mbyllura me vulë të transkripteve ose deklaratat me shkrim të Dushan Dunjiqit, Nebojsa Avramoviqit, Dëshmitarit 52, Marijana Angjelkoviqit, Stanisha Radosheviqit dhe Novak Stijoviqit, incizimet zanore dhe filmimet e dëshmive të tyre, deklaratat me shkrim të Dëshmitarit 78 dhe Dëshmitares 79 dhe dokumenti i Rregullës 65ter me numër 01137 të pranohen të mbyllura me vulë.

(3) **I KËRKON** Sekretarit që të numërtojë si prova materiale, dokumentet e pranuar, incizimet zanore dhe filmimet, dhe deklaratat me shkrim dhe transkriptet e pranuar pasi të marrë njoftim nga Prokuroria në përputhje me pikën 2(b) të pjesës vendimore.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 22 korrik 2011.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]